



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani Elezit

ZYRA E PERSONELIT

Me qëllim të përmbushjes së objektivave që dalin nga Ligjet e Republikës së Kosovës dhe që të kemi një shërbim cilësorë zyra e personelit duke u bazuar në të drejtat dhe obligimet për kryerjen e detyrave, nga kompetencat e veta të cilat ia mundëson Ligji si dhe në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Ministrin e Administratës Publike për periudhën janar-dhjetorë 2011 ka planifikuar një varg aktivitete dhe detyrash që duhet të përmbushen brenda këtij viti dhe ato janë:

- **Zbatimin e Ligjit të Shërbimit Civil dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me Shërbyesit Civil**
- **Sigurimin e funksionimit të përditshëm të procedurave siç janë: rekrutimi dhe përzgjedhja, disiplina, ankesat, lutjet, vlerësimet, e përgjithshme në konsultime me menaxherët e drejtpërdrejt, duke përfshirë edhe trajnimet e paneleve dhe komisioneve të nevojshme për t'i vënë në funksion këta procedura**
- **Në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive, identifikimi i nevojave të burimeve njerëzore**
- **Krijimin dhe mirëmbajtjen e komunikimit efektiv dhe bashkëpunimin me të gjitha funksionet në Komunë, në lidhje me çështjet e burimeve njerëzore.**
- **Sigurimin e integritetit të parimeve të mundësive të barabarta në të gjitha aspektet e punës së njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore.**
- **Udhëheqjen motivimin e ekipit të personelit, për të ngritur nivelin e përkushtimit (mënyrës së kryerjes së punës) dhe për të dhënë shërbime cilësore.**
- **Digjitalizimi i dosjeve personale konfidenciale**
- **Mbikëqyrja permanente e punës , evidentimi ditorë i shërbyesve civil Komunal**
- **Menaxhimi i pushimeve vjetore të shërbyesve civil komunal**
- **Klasifikimi dhe sistematizimi i nëpunësve civil sipas Ligjit të Shërbyesve civil**

- Në bashkëpunim me drejtorët e Drejtorive përgatit formularët dhe njofton për kohën që duhet të bëhet vlerësimi jo formal i performancës për shërbyesit civil i cili bëhet në gjashtë mujorin e parë të vitit, gjithashtu vlerësimi i fundvitit.
- Bashkëpunim me MAP-në dhe komunat e tjera e në veçanti me komunën e Kaçanikut
- Kryen edhe punë tjera sipas kompetencave dhe autorizimeve.